

AKTIVITETE NË QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE, ME PREZENCËN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DNJF, Z.ERGYS QIRICI



Diber

Në datën 11.06.2024 Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe specialistë nga Drejtoria zhvilluan një takim me përfaqësues nga gjykata, policia, prefektura, si dhe avokatë të ndihmës juridike dytësore të Qarkut Diber, në kuadër të funksionit të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Tranim “Të rrisim aksesin në drejtësi të personave në rrezik pashtetësie, të refugjatëve dhe azilkërkuesve në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale të këtyre grupeve të synuara”



Korçe

Gjirokastrë



Drejtori i Përgjithshëm z.Ergys Qirici mori pjesë në një trajnimin e realizuar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.



Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në panelin folës të mbajtur në tryezën e Rrjetit Parlamentar “Women Free from Violence”, duke theksuar parimet kryesore të Ndihmës Juridike Falas dhe zhvillimet kryesore.

ANAD (Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë) & Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve të komuniteti të njerëzve që nuk Dëgjojnë për Akses falas, në shërbimet e ndihmës juridike nëpërmjet informacionit në gjuhën e shënjave”.



Korçe



Gjirokastrë



Fier

 **QSHNJP Korçë** në datën 03.06.2024 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata Kombëtare e Njerëzve që nuk dëgjojnë, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, Z.Ergys Qirici.



 **QSHNJP Korçë** në kuadër të ditëve ndërkombëtare, 1 Qershor, Dita Ndërkombëtare e fëmijëve dhe 4 Qershor Dita Ndërkombëtare e fëmijëve të pafajshëm, Viktima të Agresionit zhvilloi një aktivitet informues në bashkëpunim me Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen, me pjesëmarrjen e punonjësve dhe fëmijëve që marrin shërbime pranë kësaj qëndre.



 **QSHNJP Korçë**, në kuadër të aktiviteteve në rang qarku në datën 14.06.2024 realizoi një takim me përfaqësues të Bashkisë Maliq, me prezencën e nënkryetarit Z.E.Rustemi, drejtorit të burimeve njerëzore Z.G.Floqi dhe specialiste të Bashkisë.

 **QSHNJP Korçë**, në kuadër të aktiviteteve në rang qarku në datën 18.06.2024 realizoi një takim me nënkryetaren, drejtoreshën e Shërbimit Social, si dhe përgjegjësen e sektorit juridik të Bashkisë Devoll.

 **QSHNJP Korçë** mori pjesë në takimin e realizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social në kuadër të datës 24 Qershor Dita e Egjiptianëve të Ballkanit.

 **QSHNJP Korçë** në datën 27.06.2024 mori pjesë në trajnimin e realizuar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me temë *“Të rrisim aksesin në drejtësi të personave në rrezik pashtetësie, të refugjatëve dhe azilkërkuesve në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale të këtyre grupeve të synuara”*.



 **QSHNJP Vlorë** në datën 24.06.2024, në kuadër të Ditës së Egjiptianëve, me pjesëmarrjen e z. Hazem Haliti, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për çështjet lidhur me komunitetin Rom dhe Egjiptian, dhe znj. Edlira Kapllanaj, Këshilltare në Këshillin Bashkiak Vlorë, si përfaqësuese e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

 **QSHNJP Dibër** në datën 11.06.2024, organizoi një takim me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë dhe përfaqësues nga gjykata, policia, prefektura, si dhe avokatë të ndihmës juridike dytësore të Qarkut Dibër.

 **QSHNJP Lezhë** në datën 14.06.2024, zhvilloi një aktivitet *“Street Law”*, në qytetin e Rreshenit, për të informuar qytetarët rreth Ndihmës Juridike Falas, Ligjit nr.111/2017 dhe funksionit të Qendrës Lezhë dhe Kurbin.



 **QSHNJP Pukë** në datën 13.06.2024 në kuadër të kalendarit të aktiviteteve Prill-Qershor 2024 organizoi një takim sensibilizues, me kategoritë e veçanta, si viktimat të Dhunës në familje, persona me aftësi të kufizuar, ndihmë ekonomike dhe persona të komunitetit Rom.

 **QSHNJP Pukë** në datën 14.06.2024, mori pjesë në takimin e organizuar nga Bashkia Pukë dhe Enti Rregullator i Ujit të Pijshëm, me pjesëmarrjen e qytetarëve të qytetit të Pukës.



 **QSHNJP Durrës** në datën 11.06.2024, në kuadër të prezantimit të manualit *“Si të përfitojme ndihmë juridike”*, në gjuhën Braille, për kategorinë e verbërve, organizoi një takim me Shoqatën e të Verbërve Durrës

 **QSHNJP Durrës** në datën 24.06.2024, organizoi një aktivitet informues, në bashkëpunim me *“Qendra Komunitare Multifunksionale Nishtulla”* dhe *“Organizata Ushten”*, në kuadër të ditës Ndërkombëtare Egjiptiane.



 **QSHNJP Kurbin** në datën 21.06.2024 zhvilloi një aktivitet në kuadër të fushatës ndërgjegjëse, informuese dhe mbështetëse me Kryetarin e Shoqatës së Para dhe Tetraplegjikëve Z.N.Ndoca.

 **QSHNJP Elbasan** në datën 28.06.2024, zhvilloi një aktivitet informues dhe promovues në Bashkinë Cërrik



QSHNJP Lushnjë në datën 25.06.2024 në kuadër të ditës së grave e vajzave viktime të dhunës në familje, organizoi një aktivitet në bashkëpunim me Qendrën Shëndetësore, Bashkia Lushnjë.



QSHNJP Lushnjë në datën 27.06.2024 zhvilloi një aktivitet me temë *“Popullsia egjiptiane në Shqipëri dhe si mundet të perfitojë Ndhmë Juridike Parësore dhe Dytësore Falas”*.



QSHNJP Kukës zhvilloi një takim në datën 27.06.2024 me përfaqësuesen e UNDP-se në Shqipëri znj. Monica Moreno.

QSHNJP Kukës zhvilloi një takim në datën 28.06.2024 brenda ambienteve të Shërbimit Social Shtetëror, Bashkia Has me punonjës të këtij institucioni në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese

QSHNJP Kukës zhvilloi një takim me qytetarët në zonat kryesore të qytetit Hasit për informimin mbi Ligjin 111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”



QSHNJP Pogradec në datën 05.06.2024 realizoi një intervistë, mbi Ndhmën Juridike Falas dhe Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, për radio LOGOS-Pogradec.

QSHNJP Pogradec mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Pogradec në kuadër të datës 24.06.2024 Ditës Ndërkombëtare të Egjiptiane të Ballkanit.


QSHNJP Pogradec mori pjesë në trajnimin me temë *“Të rrisim aksesin në drejtësi të personave në rrezik pashtetësie, të refugjatëve dhe azilkërkuesve në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale për të këtyre grupeve të synuara”*.



QSHNJP Fier në datën 21.06.2024, mori pjesë në një trajnim informues si anëtare e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje. Organizuar nga Bashkia Fier dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

QSHNJP Fier në datën 25.06.2024, zhvilloi një takim pranë Bashkisë Patos me përgjegjësen e Shërbimit Social, kodinatoren për viktimat e dhunës dhe të miturit të cilat menaxhonin raste të dhunës në familje.

QSHNJP Fier në datën 30.06.2024, së bashku me ANAD, organizuam një trajnim për ofrimin e informacionit të aksesueshem ne gjuhën e shenjave të praktikave të përfitimit të ndihmës jurike falas dhe trajnimin e komunitetit të personave që nuk dëgjojnë rreth përfitimit të ndihmës jurike falas.



QSHNJP Tiranë në datën 04.06.2024, në kuadër të prezantimit të manualit *“Si të përfitojë ndihmë juridike”*, në gjuhën Braille, për kategorinë e verbërve, organizoi një takim me persona të kësaj kategorie, si dhe në datën 13.06.2024 një takim me Kryetarin e Shoqatës së Invalidëve të Shqipërisë.

QSHNJP Tiranë në datën 19.06.2024, në bashkëpunim me Fondacionin “Harriet Martinau”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt, dha një intervistë ndërgjegjëse, në Radio-online - Arumun.

QSHNJP Tiranë në datën 25.06.2024, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, organizuan një aktivitet informues, në Qendrën Kombëtare për Trafikimin e Qenieve Njerëzore.

QSHNJP Tiranë në datën 25.06.2024, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, organizuan një aktivitet informues, ne Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Dhunës në familje.



QSHNJP Tiranë në datën 26.06.2024, organizoi një aktivitet ndërgjegjëse në bashkëpunim me Kolegjin Wisdom, i cili ka hapur edhe Klinikë Ligjore.

QSHNJP Tropojë në datën 14.06.2024, në kuadër të aktiviteteve promovuese për hapjen e Qendrës, zhvilloi një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Tropojë Z.Brahim Hajdaraj dhe specialistë pranë këtij institucioni.



QSHNJP Përmet në datën 06.06.2024 mori pjesë në sallën e Këshillit Bashkiak për të diskutuar në projektin *"Mendohu para se të klikosh"* për Sigurinë Kibernetike për gratë dhe vajzat

QSHNJP Përmet në datën 12.06.2024, Qendra Gjrokastër dhe Përmet, si dhe përfaqesues nga DNJF, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga ANAD, në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë si dhe DNJF.



QSHNJP Përmet në datën 13.06.2024, mori pjesë në takimin bashkëpunues me drejtuesit e institucioneve, ku u diskutua mbi rastet e dhunës që janë trajtuar së fundmi.


QSHNJP Përmet në datën 14.06.2024, zhvilloi një takim informues "Street Law", për shërbimet që ofron Qendra.

QSHNJP Berat në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit zhvilloi një takim me Shërbimin e Provës, Bashkia Berat

QSHNJP Berat zhvilloi në datën 07.06.2024 një takim me Administratoren Shoqërore në Drejtorinë e Shërbimit Social, Njësia Administrative Otllak Znj. Ekloida Zeqo.

QSHNJP Berat, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt zhvilloi një takim në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, me Kordinatorin e Dhunës për të mitur dhe specialistët të cilët merren me trajtimin e rasteve të Dhunës Seksuale.

QSHNJP Berat, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave zhvilloi një takim me Kordinatorët e Dhunës pranë Bashkisë Dimal dhe punonjës të Policisë të Stacionit Poshnje.



QSHNJP Shkodër, në kuadër të prezantimit të manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike", në gjuhën Braille, për kategorinë e verbërve, zhvilloi një takim informues me Shoqatën e të Verbërve, Qarku Shkodër.

QSHNJP Shkodër, në kuadër të 15 Majit "Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt", zhvilloi një takim me stafin në ambjentet e Strehzës "Për Viktimat e Trafikimit dhe Dhunës Seksuale"

QSHNJP Shkodër, në kuadër të "Ditës së Egjiptianëve" zhvilloi në bashkëpunim me Perfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit kundër Diskriminimit një takim informues në Lagjen Iliria, Shkodër.

QSHNJP Shkodër, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare kundër abuzimit dhe trafikimit të Drogave" zhvilloi në bashkëpunim me specialisten e Qendrës ATELIE, një takim në ambientet e Qendrës me të mitur/të rinjtë.

QSHNJP Shkodër, zhvilloi në bashkëpunim me Perfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit kundër Diskriminimit një takim informues në Qendrën Malteser, e cila ka në fokus fëmijët me aftësi ndryshe.



QSHNJP Mat në datën 04.06.2024, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve të pafajshëm, viktimat të agresionit" zhvilloi një takim në çerdhen nr.2 dhe Kopshtin nr.3, të qytetit të Burrelit.

QSHNJP Mat në datën 26.06.2024, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave" zhvilloi një takim në Njësinë Administrative Ulëz.

QSHNJP Mat në datën 27.06.2024, zhvilloi një aktivitet "Street Law", në Bashkinë Klos.

QSHNJP Kavajë, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve", mori pjesë në takimin e zhvilluar në bashkëpunim me ZVA Kavajë dhe Shkollën 9-vjcare "Rilindja"

QSHNJP Kavajë, në datën 10.06.2024 zhvilloi një takim në Shtëpinë e të moshuarve "Sefer Dervishi" Kavajë.

QSHNJP Gjrokastër, në datën 19.06.2024 mori pjesë në takimin e organizuar nga Avokati i Popullit, pranë Këshillit të Qarkut, Gjrokastër.

QSHNJP Gjrokastër, në datën 26.06.2024 zhvilloi një aktivitet në Bashkinë Dropull, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në rang Qarku.

QSHNJP Gjrokastër, në datën 28.06.2024 Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike dhe mbështetjen e UNHCR në kuadër të projektit të ofrimit të Ndihmës Juridike për grupet dhe individët vulnerabël në të gjithë territorin, organizojë trajnim në Gjrokastër me temë *"Të rrisim aksesin në drejtësi të personave në rrezik pashtetësie, të refugjatëve dhe azilkërkuesve në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale për të këtyre grupeve të synuara"*.

QSHNJP Gjrokastër, në datën 28.06.2024 dha një intervistë për median lokale RTGJ, e zhvilluar në ambjentet e Këshilli të Qarkut Gjrokastër

